

Emri i Lëndës : Gjuhë Shqipe II							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
ALB 102	A	Pranverë	4.00	0.00	0.00	4.00	5.00
Lektori		Rahim Ombashi, Prof. Asoc. Dr.					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Anglisht					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		Komunikimi gjuhësor është vlerë e njeriut. Vetëm njerëzit kanë aftësi të përçojnë sinjale tingëllore ose, siç thuhet ndryshe, shenja gjuhësore. Lënda e gjuhës shqipe ndihmon për të përforcuar aftësinë e të folurit me shkrim dhe gojë. Shqipja si gjuhë e shkruar dhe e folur ka sistemin e vet të veçantë shkrimor, por dhe një tërësi rregullash që formojnë strukturën e këtij sistemi. Kur analizojmë strukturën e shqipes, ndërtojmë gramatikën e saj. Përmes të mësuarit analitik dhe kritik synohet të folurit e gjuhës standard, me shkrim dhe me gojë, duke u aftësuar në ndërtimin e ligjërimit të nevojshëm					
Objektivat		<p>□ Të marrë formim bazë gjuhësor □ Të përvetësohen çështje të fonetikës, leksikologjisë, të normës morfologjike, sintaksore si dhe të drejtshkrimit të gjuhës shqipe. □ Të arrijnë studentët një akt të lartë komunikativ nëpërmjet ligjërimit normative. □ Të rrisin cilësinë gjuhësore të punimeve (ese, detyra kursi, artikuj) punim diploma □ Të nxitet të vështruarit kritik si dhe akti i korrektimit në rastet e shmangieve nga shqipja standard.</p>					
Konceptet Kryesore							
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	KULTURË GJUHËSORE Pjesa e tretë: Drejtshkrimi III. Norma dhe struktura gramatikore (Hyrje) Parimet e drejtshkrimit të shqipes - Struktura e rregullave të drejtshkrimit të shqipes						
2	Drejtshkrimi i zanoreve - Zanoret e theksuara: e, ë - Zanoret e patheksuara: e, zanorja ë paratheksore, pastheksore jofundore, fundore						
3	Grupe dhe takime zanoresh - Fjalët dhe grupet ie / je - Fjalët e huaja me ia, ie, io, iu dhe ai, ei, oi, ui - Apostrofi						
4	Shkrimi i bashkëtingëlloreve - Shkrimi s / z dhe i sh / zh / ç nistore - Shkrimi me j ose me i - Bashkëtingëlloret në grupet ce / ci, ge/gi (në fjalë të huaja) - Emrat e përveçëm të huaj						
5	Shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes - Shkrimi i fjalëve njësh - Shkrimi i fjalëve ndaras - Shkrimi me vizë lidhëse - Shkrimi me vizë të gjatë						
6	Përdorimi i shkronjave të mëdha - Emrat e përveçëm - Pjesët përbërëse të emërtimeve zyrtare - Emërtimet e përveçme dy - a më shumëfjalëshe						
7	Nyja e përparme dhe parafjalët - Shkrimi i nyjës së përparme - Shkrimi i nyjave, i pjesëzave dhe i parafjalëve të përsëritura - Ushtrime						
8	Provim Gjysmëfinal Pjesa e katërt: Pikësimi IV. Pikësimi (Hyrje) - Shenjat e pikësimit - Parimet e pikësimit - Klasifikimi i shenjave të pikësimit						
9	Shenjat e pikësimit në fund të fjalisë - Pika. Përdorime të tjera të pikës - Pikëpyetja. Pikëpyetja. Tri pikat - Përdorime të veçanta të presjes, kllapave e thonjzave - Presja. Kllapat. Thonjëzat						

10	Pikësimi i fjalisë së thjeshtë - Shenjat e pikësimit midis gjymtyrëve kryesore dhe të dyta - Gjymtyrët homogjene pa lidhëza dhe me lidhëza - Shenjat e pikësimit në fjalitë me gjymtyrë të veçara: përcaktori i veçuar, ndajshtimi i veçuar, rrethanori i veçuar. - Gjymtyrët sqaruese, plotësuese e saktësuese - Thirrori. Ndërtimet me forma të pashtjelluara. Pjesëzat pohuese, mohuese dhe dëftuese - Fjalët dhe shprehjet modale - Pashirrrmat dhe tingullimet
11	Pikësimi i periudhës - Periudha me fjali palidhëzore Fjalitë me lidhje numërimi Fjalitë me lidhje kundërshtie Fjalitë me lidhje fthilluese
12	Pikësimi i periudhës - Periudha me fjali palidhëzore Fjalitë me lidhje sqaruese e shtuese Fjalitë me lidhje shkakore Fjalitë me lidhje kushtëzimi
13	Periudha me bashkërenditje. Periudha me nënrenditje çështjet kryesore Fjalitë përcaktore Fjalitë foljore (fthilluese e rrethanore) - Periudha me fjali të ndërmjetme dhe të ndërshtëna - Pikësimi i ligjëratës së drejtë, i dialogut dhe i citimeve Ligjërata e drejtë Dialogu Citatet dhe citimet - Ushtrime
14	Periudha me bashkërenditje. Periudha me nënrenditje Fjalitë përcaktore Fjalitë foljore (fthilluese e rrethanore) - Periudha me fjali të ndërmjetme dhe të ndërshtëna - Pikësimi i ligjëratës së drejtë, i dialogut dhe i citimeve Ligjërata e drejtë Dialogu Citatet dhe citimet - Ushtrime
15	Përsëritje
16	Provim Final
Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	<ul style="list-style-type: none"> • I. Literatura e Detyrueshme: Rami Memushaj, SHQIPJA STANDARDE - Si ta flasim dhe ta shkruajmë, Tiranë, 2011. Rami Memushaj, GJUHA SHQIPE NË SHTRATIN E PROKRUSTIT, Tiranë, 2013. 4. Bahri Beci, Gramatika e gjuhës shqipe, EDFA, Tiranë, 2010. 5. Thomas S. Kane, Si të shkruajmë shqip, Tiranë, 2010. Cikël leksionesh nga lektori i lëndës. (Ky cikël është hartuar duke u bazuar në literaturën e detyrueshme, por edhe në atë të këshillueshme). • Rami Memushaj, GJUHA SHQIPE NË SHTRATIN E PROKRUSTIT, Tiranë, 2013. • Bahri Beci, Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë, Tiranë: Botimet EDFA, 2004.
Referenca të tjera	<ul style="list-style-type: none"> • ASHSH, Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe, Tiranë, 1973. • ASHSH, Fjalor Drejtshkrimor i Gjuhës Shqipe, Tiranë, 1976. • ASHSH, Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, Tiranë, 1980 • ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe, vol. 1 dhe 2, Tiranë, 1995, 2002. • Thomas S. Kane, Si të shkruajmë shqip, Tiranë, 2010.
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Të njihet studenti me rregullat themelore të artit të shkruarit
2	Studenti duhet të kryejë punime me nivel të lartë gjuhësor (ese, detyra kursi, punim diplome)
3	Të nxitet të menduarit kritik duke u shfaqur në aktin e korrektimit në rastet e shmangies nga shqipja standarde.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	20	
Kuize	1	5	
Projekte	1	20	
Projekte semestrare	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	5	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final		50	
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final		50	
Total		100	
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	1	0	0
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	10	10
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			126
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.04
ECTS			5.00